



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

г./v. \_\_\_\_\_



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 60-të, të mbajtur më 31.01.2022, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi me numër 12 - 2620/1 e datës 30.07.2021, e dorëzuar nga parashtrues i panjohur, REFUZOHET

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent sepse denoncimi nuk përmban pretendime të qarta apo indikacione për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar në ushtrimin e autoriteti publik dhe detyrës zyrtare dhe nuk ka mundësi të ofrojë informacion shtesë në lidhje me pretendimet në denoncim.

Lënda me numër 12-2620/1 të datës 30.07.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga ana e një parashtruesi të panjohur është dorëzuar denoncim të regjistruar me numër 12-2620/1 nga data 30.07.2021, pas së cilës është formuar lënda me të dhëna për ngjarjet në /// dhe në të cilin dyshohet se procedura pas shpalljes së shpallur për punësimin e personave në /// do të realizohet ligjërisht dhe në mënyrë të duhur.

Përndryshe, parashtruesit e denoncimit dyshojnë se në procedurën pas shpalljes do të punësohen persona pa përvojën e nevojshme të punës dhe të cilët kanë qenë të afërt me kandidatin e vjetër-re për kryetar të Komunës ////, e jo të rinj të cilët realisht e kanë merituar të punësohen. Në denoncimin anonim paraqiten pretendime të përgjithshme dhe paushallë lidhur me personat për të cilët parashtruesit dyshojnë se do të punësohen pas shpalljes, pa dhënë informacion specifik dhe të mjaftueshëm se për cilin konkurs bëhet fjalë dhe cilat vende pune janë ofruar për t'u plotësuar me të.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve të denoncuar, KSHPK-ja konstatoi se denoncimi përmban pretendime të përgjithshme, nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve gjatë ushtrimit të autoritetit publik dhe detyrës zyrtare dhe KSHPK-ja nuk ishte në gjendje të jepte informacione

shtesë për pretendimet në denoncim (denoncim anonim), pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent dhe vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

КОМИСИОНИ СХТЕТЁРОР  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Nënkryetar  
Goran Trpenoski

Dorëzuar deri te:

- Parashtruesi i denoncimit

Punoi: J.C.

Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

